



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 531/3 Prot.

Tiranë, më 19.09.2022

V E N D I M

Nr. 180, Datë 19.09.2022

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja a), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar¹, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën me nr. 56 Regj, datë 29.03.2022, të paraqitur nga “Shoqata e Invalidëve Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë, Dega Tiranë”, kundër Bashkisë Tiranë, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “aftësisë së kufizuar”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Me anë të Vendimit nr. 662, datë 08.05.2003, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, “Shoqata e Invalidëve Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë, Dega Tiranë” (në vijim cituar Shoqata), është regjistruar si person juridik/organizatë joqeveritare, me seli në Tiranë, me kohëzgjatje të papërcaktuar, me kryetar A. P³.

Sipas shpjegimeve të dhëna, A. P, në cilësinë e përfaqësuesit të Shoqatës, në mes të tjerash informon se, me vendimin e datës 19.07.2002 të Bashkisë Tiranë, Shoqatës i është dhënë një zyrë në përdorim. Mirëpo, kjo zyrë është prishur pa qenë të informuar dhe njoftuar paraprakisht ata si

¹ Në vijim do t’i referohemi me akronimin LMD.

² Në vijim do t’i referohemi me akronimin KMD ose si *Komisioneri*.

³ Referuar Vërtetimit datë 06.12.2019, të Zyrës së Regjistrimit të OJF-ve, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Shoqatë. Lidhur me këtë fakt, përfaqësuesi i Shoqatës, z. P, ka informuar se i është drejtuar institucioneve përgjegjëse për ta denoncuar atë.

Në ankesën e sjellë pranë KMD-së, Shoqata ka pretenduar se po diskriminohet nga Bashkia Tiranë, pasi nuk u është vënë në dispozicion një zyrë e përshtatshme dhe afër qendrës së Tiranës, pasi atyre u është ofruar mundësia për t'u dhënë në përdorim një zyrë tek ish-Reperti Ushtarak në Surrel. Këtë fakt Shoqata e ka kundërshtuar, me arsyetimin se rruga për tek objekti i ofruar është e pashtuar, nuk ka drita, ujë, si dhe nuk është mjedis i përshtatshëm për punë. Arsyeja tjetër se përse Shoqata kërkon që zyra t'i jepet afër qendrës së qytetit, është për arsye shëndetësore, pasi individët që mund të kenë nevojë të adresojnë problematikat e tyre pranë kësaj zyre, janë invalidë paraplegjikë dhe tetraplegjikë që lëvizin me karroca me rrota, gjë e cila pamundëson lëvizjen e tyre në një distancë aq të largët dhe në rrugë të pashtuar e të vështirë për të lëvizur për ta. Në këto kushte, pamundësohet veprimtaria e Shoqatës dhe përmbushja e objektivave të saj, duke çënuar njëherësh edhe qëllimin për të cilin ajo është krijuar dhe ekziston.

Moszgjidhjen e kësaj problematike nga ana e Bashkisë, Shoqata, e sheh si një diskriminim që i bëhet asaj, pikërisht për shkak të aftësisë së kufizuar, duke i mohuar një të drejtë që buron nga parashikimet ligjore.

Ligji nr. 8626, datë 22.06.2000 "*Për statusin e Invalidit Paraplegjik dhe Tetraplegjik*", njeh rolin aktiv të shoqatave në mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të individëve me paraplegji dhe tetraplegji. Në këtë kontekst, shteti financon veprimtarinë e Shoqatës sipas burimeve financiare të planifikuara për këtë qëllim, duke vënë në dispozicion të saj dhe të japë falas mjedise për zhvillimin e veprimtarisë së saj⁴.

Në përfundim të ankesës, Shoqata e Invalidëve Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë Dega Tiranë, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, zgjidhjen e problematikës, duke ndërhyrë për marrjen e masave nga ana e Bashkisë Tiranë për pajisjen e Shoqatës me zyrë të përshtatshme, brenda qytetit të Tiranës.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

"Shoqata e Invalidëve Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë, Dega Tiranë" është një organizatë jofitimprurëse, regjistruar si person juridik, me vendimin nr. 662, datë 08.05.2003, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Referuar akteve themeluese, shoqata ka si qëllim dhe objekt të veprimtarisë së saj mbrojtjen e interesave të anëtarëve të saj të me paralegji dhe tetraplegji.

Bazuar në ankesën e paraqitur pala ankuese, pretendon se është çënuar në interesin e saj të ligjshëm dhe të drejtpërdrejtë, si person juridik, pasi trajtohet në mënyrë të padrejtë dhe më pak të favorshme, duke mos përfituar përse i takon ofrimit të mjediseve nën administrimin e Bashkisë Tiranë, pa kundërshtim, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 8626, datë 22.06.2000 "*Për statusin e Invalidit Paraplegjik dhe Tetraplegjik*".

⁴ Neni 14, i ligjit nr. 8626, datë 22.06.2000 "*Për statusin e Invalidit Paraplegjik dhe Tetraplegjik*".

Pala ankuese pretendon se është diskriminuar për sa kohë që dispozitat ligjore nëpërmjet të cilave Shoqata është përfituese në mënyrë të drejtpërdrejtë, nuk zbatohen nga ana e Bashkisë.

Bazuar në nenin 32, pika 1, shkronja b), të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet:

“1. Komisioneri ka kompetencë:

... b) të shqyrtojë ankesat nga organizatat që kanë një interes të ligjshëm për të vepruar në emër dhe me pëlqimin me shkrim të individëve ose grupeve të individëve që pretendojnë se ka ndodhur diskriminimi ose në emër të tyre për çështje që lidhen me interesa kolektive...”

Bazuar në nenin 4, të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku përcaktohen subjektet e ligjit, parashikohet:

1. Ky ligj zbatohet për të gjithë personat, që jetojnë dhe qëndrojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. 2. Shtetasit shqiptarë, me banim të përkohshëm ose të përhershëm jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë, gëzojnë mbrojtjen, që ofron ky ligj, në marrëdhëniet me organet shtetërore shqiptare. 3. Personat fizikë e juridikë të huaj, me banim, vendqëndrim apo seli jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, gëzojnë mbrojtjen, që ofron ky ligj, në marrëdhëniet me organet shtetërore shqiptare.”

Bazuar në nenin 32, pika 3, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se:

“3. Për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, komisioneri zbaton normat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, me përjashtim të procedurave që parashikohen nga ky ligj”.

Bazuar në nenin 3, pika 7 dhe 8, të Kodit të Procedurave Administrative, përcaktohet se:

““Palë” është:

a) çdo person fizik ose juridik, i cili ka të drejtë ose interes legjitim të drejtpërdrejtë në një procedurë administrative, siç përcaktohet në nenin 33, pika 1, të këtij Kodi;

b) një palë që nuk ka një të drejtë ose interes legjitim të drejtpërdrejtë në një procedurë administrative, siç përcaktohet në nenin 33, pikat 2 dhe 3, të këtij Kodi, por që të drejtat ose interesat e saj ligjshëm mund të cenohen nga rezultati i procedurës.

Person është çdo person fizik, juridik, si dhe çdo subjekt i së drejtës, sipas legjislacionit në fuqi.”

Referuar nenit 33, pika 1, të Kodit të Procedurave Administrative, përcaktohet se:

“1. Palë në procedurën administrative, përveç sa parashikohet në nenin 3, të këtij Kodi, është çdo person:

a) me kërkesë të të cilit ka filluar procedura administrative;

b) ndaj të cilit ka filluar procedura administrative, ose të cilit i drejtohet apo synohet t’i drejtohet vendimi i procedurës administrative;

c) me të cilin organi publik synon të lidhë apo ka lidhur një kontratë administrative.....”

Bazuar në këto dispozita ligjore, pala ankuese, “Shoqata e Invalidëve Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë, Dega Tiranë”, në cilësinë e personit juridik, është subjekt i ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, dhe legjitimohet për të paraqitur ankesën objekt shqyrtimi.

Komisioneri gjykon se, në adresimin e kësaj problematike kanë interes legjitim të gjitha organizatat apo subjektet përfaqësuese të personave më aftësi të kufizuara me paraplegji dhe tetraplegji, të cilat janë të regjistruara në Republikën e Shqipërisë sipas legjislacionit në fuqi dhe kanë si objekt të deklaruar të veprimtarisë mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të tyre.

Shkaku i pretenduar nga ankuesi *aftësia e kufizuar*, është shkak i mbrojtur nga neni 1, i ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se:

“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Bazuar në nenin 3, pika 2, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet se:

“2. “Diskriminim i drejtpërdrejtë” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji.”

Bazuar në nenin 7, pika 1, të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë, që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Mbrojtja nga diskriminimi në fushën e ofrimit të të mirave dhe shërbimeve, gëzon një mbrojtje të veçantë në kuadër të Kreut IV, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Konkretisht në nenin 20, pikat 1 dhe 2, të po këtij ligji, përcaktohet se:

“1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t'i arrijë ose t'i përdorë ato
a) duke refuzuar t'i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji;

b) duke refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.

2. Pika 1 e këtij neni zbatohet veçanërisht për:

c) kontributin dhe mundësinë për të përfituar të mira nga skemat e mbrojtjes shoqërore, duke përfshirë asistencë sociale, sigurime shoqërore, mbrojtje të fëmijëve, përfitim për shkak të aftësisë së kufizuar, apo ndonjë skemë tjetër të mbrojtjes sociale ose avantazh tjetër social të ofruar për publikun;...”

Ankesa e paraqitur është në përputhje me kërkesat e nenit 33, pika 3, të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar dhe u pranua për shqyrtim, pasi nuk ekziston asnjë nga shkaqet për mospranim të përcaktuara nga neni 33, pika 4, të po këtij ligji.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Nëpërmjet me nr. 531/1 prot., datë 06.04.2022 Komisioneri i ka kërkuar informacion dhe dokumentacion⁵ në cilësi prove, Bashkisë Tiranë, lidhur me pretendimin e subjektit ankues.

Referuar dokumentit, Lajmërim marrje poste nr: RR 032 502 940 AA, datë 07.04.2022 rezulton se, shkresa sipërcituar është marrë në dorëzim nga Bashkia Tiranë, e cila ka marrë dijeni për të, në kushtet kur dokumenti është nënshkruar nga punonjësi i këtij Institucioni, po ashtu dhe nga nëpunësi i shërbimit postar.

2. Në mungesë të përgjigjes zyrtare nga ana e Bashkisë, Komisioneri, mbështetur në nenin 33, pika 8, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të kësaj ankese, nëpërmjet shkresës me nr. 531/2 prot., datë 08.06.2022, njoftoi palët për pjesëmarrjen në seancë dëgjimore.

Me datë 22.06.2022, nga ana e Bashkisë Tiranë nuk u paraqit asnjë përfaqësues i këtij Institucioni. Referuar dokumentit, Lajmërim marrje poste nr: RR 048 023 076 AA, datë 10.06.2022 rezulton se, shkresa sipërcituar është marrë në dorëzim nga Bashkia Tiranë, e cila ka

⁵ Informacion lidhur me faktin nëse për Shoqatën e Invalidëve Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë Dega Tiranë, ka patur një mjedis pune/zyrë të vënë në dispozicion nga ana e Bashkisë. Nëse po, kopje të akteve provuese (Kontrata, marrëveshje, etj).

Parashtrime dhe kopje të korrespondencës zyrtare të mbajtur me Shoqatën, lidhur me kërkesën e saj për t’u pajisur me zyrë të re, pas shembjes së zyrës (në Laprakë) me datë 03.02.2022, nëse ka. (kërkesa të Shoqatës dhe kthim përgjigjet e Bashkisë).

Cilat janë masat e ndërmarra nga ana e Bashkisë për pajisjen me zyrë të Shoqatës, pas datës 03.02.2022?

Cila është procedura ligjore/praktika që ndjek Bashkia lidhur me kërkesat e një organizate joqeveritare për pajisjen me zyrë, kur kjo e drejtë përcaktohet shprehimisht në ligjin specifik?

Si dhe çdo informacion tjetër që gjykohet i arsyeshëm dhe do të ndihmonte në sqarimin e plotë të kësaj çështjeje.

marrë dijëni për të, pasi dokumenti është nënshkruar nga punonjësi i këtij Institucioni, gjithashtu dhe nga nëpunësi i shërbimit postar.

“Shoqata e Invalidëve Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë, Dega Tiranë”, u përfaqësua nga kryetari i saj z. Ali Plaka.

Bazuar në procesverbalin e mbajtur me kryetarin e Shoqatës, konstatohet se subjekti ankues u qëndroi të njëjtave parashtrime që kishte bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor me KMD-në, duke kërkuar që problematika e tyre të zgjidhej përfundimisht nëpërmjet marrjes në përdorim të një mjedisi/zyre pune të përshtatshme, brenda qytetit të Tiranës.

3. Me shkresën me nr. 21727/2 prot., datë 13.07.2022, Bashkia Tiranë, parashtrroi si më poshtë vijon:

“Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale nëpërmjet Drejtorisë së Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale, pranë Bashkisë Tiranë, ka realizuar Marrëveshjen e Bashkëpunimit nr. 12408/1 prot., datë 23.03.2021 mes Bashkisë Tiranë dhe Shoqatës së Invalidëve Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë të Shqipërisë.

.....

Shoqata i është drejtuar Bashkisë dhe Ministrisë së linjës, me kërkesën me nr. 19/2 prot., datë 13.07.2017, në vijimësi të kërkesave të tjera të paraqitura pranë Ministrisë për sigurimin e mjediseve të përshtatshme për vazhdimin e aktiviteteve të Shoqatës.

.....

Në vijim të korrespondencës shkresore të Bashkisë të Tiranës, Ministrisë dhe Shoqatës, pas shqyrtimit të kësaj kërkesë dhe vlerësimit të projektit konkret të propozuar, i cili merret në konsideratë për efektshmërinë e tij lidhur me shërbimin specifik që do të sigurojë për PAK, Bashkia e Tiranës, pasi bëri të mundur verifikimin e të gjithë ambienteve në administrimin e saj, mbi plotësimin e disa kriterëve të posaçme lidhur me këtë qëllim është dakordësuar dhe ka finalizuar Vendimin nr. 176, datë 21.12.2020, të Këshillit Bashkiak për “Miratimin e dhënies në përdorim të ambientit të pronës nr. 99, me emërtim Ish-Reparti Ushtarak nr. 5011/45, vendndodhje në Surrel, Farkë, Tiranë, Shoqatës së Invalidëve Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë të Shqipërisë”. Theksojmë se ky vendim është realizuar me dakordësi të plotë dhe iniciuar me kërkesë të Shoqatës.

Me zbardhjen e vendimit sipërcituar është realizuar dhe Kontrata e Hua Përdorjes me nr. 4389/1, datë 16.02.2021, duke i dhënë mundësinë e përdorimit pa kundërshpërblim, për një afat 10 vjeçar Shoqatës, si dhe nga ana e Drejtorisë së Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale është realizuar Marrëveshja e Bashkëpunimit nr. 12408/1 prot., datë 23.03.2021, me të drejtë rinovimi me qëllim mundësinë bashkëpunimit në ofrimin e shërbimeve sociale për kategorinë të cilën kjo Shoqatë përfaqëson. Në lidhje me mundësinë e rrethimit të pronës dhe çdo element që lidhet me të, kjo Shoqatë është vënë në dijeni nëpërmjet shkresës me nr. Sh-3108/4, datë 10.05.2022 nga Drejtorinë përkatëse të Bashkisë Tiranë, se projekti i kërkuar është bërë pjesë në programin buxhetor 2022-2024.

Në përfundim, sqarohet se, Bashkia e Tiranës në asnjë moment nuk ka shprehur diskriminimin e cituar nga z. Ali Plaka, përfaqësues i Degës Tiranë i kësaj Shoqate, por ka patur dhe ka fokus kryesor bashkëpunimin lidhur me kategorinë që kjo Shoqatë përfaqëson.

Bashkia e Tiranës ka në prioritet të punës së saj përmirësimin e rritjen e mirëqenies sociale për të gjitha kategoritë sociale përmes zbatimit të programeve të përkujdesit social dhe ngritjes së kapaciteteve shërbimofruese në të gjithë qytetin e Tiranës....”

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm.

Si rregull, me qëllimin për të përcaktuar nëse subjektet ankues janë trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë apo të pafavorshme krahasuar me shtetas/individë të tjerë në një situatë të njëjtë apo të ngjashme me të, nevojitet “krahasuesi”.

Mirëpo, në kushtet kur ky “krahasues” mungon, vlerësohet nëse ankuesi është trajtuar në mënyrë të padrejtë në raport me parashikimet ligjore.

Në këtë kontekst, Komisioneri ka analizuar dhe vlerësuar trajtimin që Bashkia i ka bërë ankuesit në raport me të drejtat e tij ligjore.

A.1 Lidhur me pretendimin e subjektit ankues, se është trajtuar në mënyrë të padrejtë, e të pafavorshme nga ana e Bashkisë Tiranë, përsa i takon mospajisjes së “Shoqatës së Invalidëve Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë, Dega Tiranë””, me ambient zyre të përshtatshëm, për ushtrimin e aktivitetit të saj.

Bazuar në analizimin e fakteve e kronologjinë e ngjarjeve, rezulton se:

Me Vendimin nr. 662, datë 08.05.2003, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, “Shoqata e Invalidëve Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë Dega Tiranë” (në vijim cituar Shoqata), është regjistruar si person juridik/organizatë joqeveritare, me seli në Tiranë, me kohëzgjatje të papërcaktuar.

Në Vendimin sipërcituar, është përcaktuar se, qëllimi i veprimtarisë së Shoqatës do të jetë:

- “Sigurimi i një statusi të përshtatshëm të invalidit që t’i përgjigjet gjendjes së rëndë dhe problematikës që kanë invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, si dhe nivelit ekonomik që do të ketë shoqëria në etapa të caktuara;
- sigurimi i një shërbimi mjekësor të përshtatshëm profilaktik dhe rehabilitues në klinika të veçanta, si dhe në klinikat e specializuara ekzistuese;
- sigurimi i një trajtimi qytetar me prioritet dhe lehtësimet e mundshme që u duhen bërë kësaj kategorie invalidësh në fushat: shkollim, punësim, strehim, lëvizje urbane e interurbane, llixha, mjete lëvizëse për shtëpi e jashtë saj, mjete komunikimi, etj”.

Në kuadër të funksionimit dhe ushtrimit të veprimtarisë së saj, Shoqata, ka patur në përdorim një ambient zyre, në një nga mjediset në pronësi të Bashkisë Tiranë⁶, dhënë nga kjo e fundit, pa kundërshtim në favor të Shoqatës.

Bazuar në aktet e vëna në dispozicion, rezulton që në muajin shkurt 2022, ky ambient në përdorim të Shoqatës ishte prishur me qëllim ndërtimin e disa objekteve nga një subjekt privat, pa asnjë njoftim paraprak, duke dëmtuar edhe gjithë bazën materiale e dokumentacionin e Shoqatës, të ndodhur në këtë mjedis. Lidhur me këtë fakt, Shoqata ka depozituar kallëzimin penal me datë 07.02.2022, para oficerit të Policisë Gjyqësore, pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Lidhur me këtë problematikë, Shoqata i është drejtuar institucioneve të ndryshme, po ashtu ka kërkuar nga Bashkia Tiranë, që të pajiset me mjedis zyre të përshtatshëm, në përputhje me kërkesat e kriteret e aksesueshmërisë referuar aftësisë së kufizuar të tyre, në një nga godinat në pronësi të kësaj Bashkie.

Bazuar në sa më sipër, për shqyrtimin e ankesës, Komisioneri në përputhje me ligjin ka kërkuar informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm, lidhur me problematikën në fjalë, në mënyrë që të mund të vlerësoje me objektivitet pretendimet e Shoqatës për trajtim diskriminues nga ana e Bashkisë, përsa i takon mospajisjes së saj me një mjedis pune/zyrë, në funksion të përmbushjes së veprimtarisë së saj.

Neni 3, i ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ka parashikuar se: “Vetëqeverisja vendore në Republikën e Shqipërisë siguron qeverisjen e efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve nëpërmjet:

a) njohjes së ekzistencës së identiteteve dhe vlerave të ndryshme të bashkësive; b) respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve, të sanksionuara në Kushtetutë ose në ligje të tjera; c) zgjedhjes së llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësive të tjera publike vendore në dobi të bashkësisë; ç) ushtrimit efektiv të funksioneve, kompenzimeve dhe realizimit të detyrave nga organet e vetëqeverisjes vendore; d) realizimit të shërbimeve në formë të përshtatshme, bazuar në nevojat e anëtarëve të bashkësisë; dh) nxitjes efektive të pjesëmarrjes gjithë-përfshirëse të bashkësisë në qeverisjen vendore; e) realizimit të shërbimeve, në përputhje me standardet e kërkuara me ligj ose akte të tjera normative”.

Bazuar në nenin 9, pikat 1.2 dhe 1.5, të këtij Ligji, përcaktohet shprehimisht se, njësitë e vetëqeverisjes vendore, ndër të tjera, kanë dhe të drejtën dhe përgjegjësinë e pronësisë:

“1.2.....

a) njësitë e vetëqeverisjes vendore ushtrojnë të drejtën e pronësisë. Ato fitojnë, shesin dhe japin në përdorim pronën e paluajtshme ose të luajtshme të tyre, si dhe ushtrojnë të drejtën e tjera, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj;

.....1.5. Të drejtën e bashkëpunimit, sipas së cilës: a) për kryerjen e shërbimeve specifike në emër dhe në dobi të komuniteteve përkatëse, dy ose më shumë njësi të vetëqeverisjes vendore

⁶ Me vendimin e datës 19.07.2002 të Bashkisë Tiranë, Shoqatës i është dhënë një zyrë në përdorim.

mund të ushtrojnë së bashku çdo funksion që u është dhënë atyre me ligj, nëpërmjet zbatimit të marrëveshjeve ose kontratave të përbashkëta, delegimit të kompetencave dhe përgjegjësive të veçanta njëra-tjetrës ose kontraktimit me një palë të tretë;”.

Neni 14, i ligjit nr. 8626, datë 22.06.2000 “*Statusi i Invalidit Paraplegjik dhe Tetraplegjik*”, ka përcaktuar detyrimin e shtetit për vënien në dispozicion dhe dhënien falas të mjediseve për zhvillimin e veprimtarisë së shoqatës së invalidëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë.

Kjo dispozitë ligjore e lë në detyrim të shtetit përmbushjen e këtij detyrimi, dhe në këtë kontekst, Komisioneri vëren se, pushteti vendor është pjese e pandarë e integrale e shtetit shqiptar, i cili ekziston dhe funksionon si një tërësi institucionesh që veprojnë e ndërveprojnë bashkarisht, secili në mënyrë të pavarur.

Shqipëria është shtet unitar, qeverisja e të cilit është e organizuar në dy nivele, në nivel qendror dhe në nivel vendor. Ndërmjet dy niveleve të qeverisjes ekziston një marrëdhënie ndërvarësie. Në përgjithësi, janë organet e pushtetit qendror, të cilët marrin vendime strategjike, të cilat zbatohen më pas nga organet e pushtetit vendor. Organizimi i këtyre pushteteve përcaktohet qartë në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë si dhe në kuadrin përkatës ligjor. Marrëdhëniet ndërmjet organeve të njësisë të qeverisjes vendore dhe marrëdhëniet e tyre me organet e pushtetit qendror bazohen në parimin e subsidiaritetit dhe të bashkëpunimit për zgjidhjen e problemeve të përbashkëta.

Pushteti ekzekutiv, apo qeveria me gjithë aparatit administrativ të saj kujdeset për shumë fusha, duke marrë iniciativa, duke krijuar institucione, duke kontrolluar etj. Pikërisht fakti që qeveria (*pushteti ekzekutiv*) ka detyra shumëdimensionale, të cilat shtrihen në të gjithë territorin e shtetit, bën që të lindë nevoja e ndarjes së saj në dy nivele: niveli qendror/qeverisja qendrore (qeveria apo këshilli i ministrave) dhe niveli periferik/qeverisja lokale (*vendore*) që nënkupton qeverisjen sipas njësive territoriale të shtetit.

Në këtë këndvështrim, bashkëpunimi ndërmjet dy niveleve të qeverisjes mund të arrihet me përcaktimin e qartë të funksioneve dhe përgjegjësive të tyre, duke siguruar autonominë dhe njëkohësisht ndërvarësinë ndërmjet nivelit qendror dhe atij vendor të qeverisjes. Autonomia vendore është konsideruar si një ndër parimet kryesore të qeverisjes në Shqipëri. Konkretisht, Kushtetuta parashikon se, qeverisja vendore në Republikën e Shqipërisë ngrihet në bazë të parimit të decentralizmit të pushtetit dhe ushtrohet sipas parimit të autonomisë vendore. Zbatimi i këtij parimi duhet marë në konsideratë gjatë gjithë veprimtarisë së shtetit.

Në këtë kontekst, bazuar në kompetencat dhe autoritetin që i njeh ligji nr. 139/2015 “*Për vetëqeverisjen vendore*”, i ndryshuar, Bashkia, si pjesë e pushtetit vendor, ka detyrimin ligjor për dhënien falas të mjediseve mjediseve për zhvillimin e veprimtarisë së shoqatës së invalidëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë.

Neni 9⁷, i këtij Ligji, ka përcaktuar se:

⁷Të drejtat dhe përgjegjësitë.

“1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë këto të drejta dhe përgjegjësi:

1.1. Të drejtën dhe përgjegjësinë e vetë-qeverisjes, sipas së cilës:

- a) përcaktojnë masa që ato i gjykojnë të nevojshme për kryerjen e funksioneve dhe ushtrimin e kompetencave;*
- b) bazuar në Kushtetutë, në ligje dhe aktet nënligjore, të nxjerra në bazë dhe për zbatim të tyre, për kryerjen e funksioneve dhe ushtrimin e kompetencave, nxjerrin urdhëresa, vendime dhe urdhra;*
- c) krijojnë struktura administrative për kryerjen e funksioneve dhe ushtrimin e kompetencave të tyre, sipas ligjeve në fuqi;*
- ç) krijojnë njësi ekonomike dhe institucione në varësi të tyre. d) krijojnë komitete, borde ose komisione për kryerjen e funksioneve të veçanta sa herë që paraqitet nevoja, duke respektuar ligjin për barazinë gjinore.*

1.2. Të drejtën dhe përgjegjësinë e pronësisë:

- a) njësitë e vetëqeverisjes vendore ushtrojnë të drejtën e pronësisë. Ato fitojnë, shesin dhe japin në përdorim pronën e paluajtshme ose të luajtshme të tyre, si dhe ushtrojnë të drejta të tjera, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj;*
- b) e drejta e fitimit të pronës, nëpërmjet shpronësimeve për interes publik, nga ana e njërive të vetëqeverisjes vendore, bëhet sipas mënyrës së përcaktuar me ligj;*
- c) e drejta e pronësisë ushtrohet nga këshilli përkatës, i cili nuk mund t’ia delegojë ushtrimin e kësaj të drejte askujt tjetër.*

.....

1.5. Të drejtën e bashkëpunimit, sipas së cilës:

- a) për kryerjen e shërbimeve specifike në emër dhe në dobi të komuniteteve përkatëse, dy ose më shumë njësi të vetëqeverisjes vendore mund të ushtrojnë së bashku çdo funksion që u është dhënë atyre me ligj, nëpërmjet zbatimit të marrëveshjeve ose kontratave të përbashkëta, delegimit të kompetencave dhe përgjegjësisë të veçanta njëra-tjetrës ose kontraktimit me një palë të tretë;*
- b) bashkëpunojnë me njësi të vetëqeverisjes vendore të vendeve të tjera dhe përfaqësohen në organizata ndërkombëtare të pushteteve vendore, në përputhje me këtë ligj dhe legjislacionin në fuqi;*
- c) kanë të drejtë të organizohen në shoqata, në përputhje me legjislacionin përkatës.*

1.6. Të drejtën e personit juridik: Si persona juridikë, njësitë e vetëqeverisjes vendore gëzojnë dhe ushtrojnë të gjitha të drejtat e përcaktuara në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë dhe në legjislacionin në fuqi dhe në mënyrë të veçantë:

- a) të drejtën e lidhjes së kontratës;*
- b) të drejtën e krijimit të personave të tjerë juridikë;*
- c) të drejtën e ngritjes së padisë civile;*
- ç) të drejtën e mbajtjes së llogarive;*

d) të drejta të tjera për ushtrimin e funksioneve në bazë dhe në zbatim të ligjeve dhe akteve nënligjore.”.

Sipas nenit 24, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, Bashkive i atribuohen përgjegjësi edhe për kryerjen e këtyre funksioneve në fushën e shërbimeve sociale:

“1. Krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale, në nivel vendor, për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë, gratë kryefamiljare, gratë e dhunuara, viktimat të trafikut, nëna apo prindër me shumë fëmijë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

2. Ndërtimin dhe administrimin e banesave për strehimin social, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

3. Ndërtimin dhe administrimin e qendrave për ofrimin e shërbimeve sociale vendore.

4. Krijimin, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mirëqenien sociale, të fondit social për financimin e shërbimeve, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj”.

E drejta e institucionit të Bashkisë Tiranë dhe tagri i saj si person juridik për lidhjen e kontratave e dhënien në përdorim të pronave të paluajtshme ose të luajtshme të saj, sipas mënyrës së përcaktuar me ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, është sanksionuar edhe në nenin 39, të “Rregullores për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e administratës së institucionit të Bashkisë Tiranë”⁸.

Ky akt rregullator sanksionon se Bashkia Tiranë, përmes Drejtorisë së Përgjithshme Juridike, Pronave të Pluajtshme dhe Licensimit, është përgjegjëse për:

- Miradministrimin e çdo çështje që lidhet me garantimin e pajtueshmërisë së politikave të ndjekura nga Bashkia e Tiranës në fushat ku kjo e fundit ushtron funksionet dhe veprimtarinë e saj, me kuadrin ligjor në Republikën e Shqipërisë; si dhe për administrimin e çdo çështje që lidhet me hartimin, përmirësimin e standardizimin e kontratave /marrëveshjeve/ memorandumeve, që Bashkia e Tiranës lidh me subjekte fizike dhe juridike, vendase e të huaja, në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, marrëveshjet ndërkombëtare dhe aktet ligjore e nënligjore që janë në fuqi;
- Miradministrimin e çdo çështje që lidhet me identifikimin, regjistrimin dhe inventarizimin e pronave të paluajtshme në pronësi të Bashkisë, menaxhimin e procesit të administrimit të ndërmarrjeve jo buxhetore në vartësi të Bashkisë Tiranë, duke respektuar parimet e transparencës dhe të ligjshmërisë, menaxhimin dhe monitorimin e procesit të shpronësimeve ose për të marrë në përdorim të përkohshëm për interes publik, pasuritë e personave fizikë ose juridikë privatë, duke garantuar mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të pronarëve përkatës, në respekt të plotë të ligjit;
- Zbatimin e strategjive, politikave dhe planeve të fushës përkatëse në të gjithë territorin e Bashkisë, si dhe për sektorët në varësi, programet, veprimtaritë dhe proceset që menaxhohen prej saj, në përputhje me parimet e ligjshmërisë dhe të transparencës;

⁸ Miratuar me Urdhrin nr. 48492, datë 20.12.2019, të Kryetarit të Bashkisë.

- Administrimin e çdo çështje që lidhet me identifikimin, verifikimin, inventarizimin (plotësimi i listave të inventarit të pasurive të paluajtshme të Njësisve Administrative, hartimi i listave të reja) të pronave të paluajtshme shtetërore që ndodhen brenda territorit nën juridiksionin e Bashkisë Tiranë duke synuar ofrimin e një shërbimi sa më të efektshëm dhe korrekt ndaj qytetarëve të Tiranës, me qëllim arritjen e objektivave dhe përmbushjen e rezultateve të kërkuara nga kjo njësi organizative.

Bashkia Tiranë, në përmbushje të detyrimeve të kësaj Rregulloreje, ndër të tjera, gjithashtu:

- Monitoron përpilimin e plotësimit të formularëve të përcaktuar sipas ligjit dhe llojit të pasurisë për pronat shtetërore, bazuar në informacionin e tërhequr nga ZVRPP-ja, Tiranë, relacioneve të Këshillit Bashkiak për proçese të ndryshme të Sektorit, etj;
- Ndjek përgatitjen e materialeve hartografike (fragmenteve të hartës, etj) për proçesin e konfirmimit për institucionet dhe drejtoritë brenda dhe jashtë Bashkisë Tiranë;
- Siguron një sistem të shëndoshë të kontrollit të brendshëm për përgatitjen e administrimit teknik, të proçedurave gjatë inventarizimit të pronave (tjetërsime të pronës publike apo zënie të paligjshme të saj) bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga ndërmarrjet dhe institucionet në varësi të Bashkisë si dhe verifikimeve të bëra sipas kërkesave të eprorit;
- Kontrollon dhe miraton proçedurat e kontratave të qirasë dhe detyrimet e ndërmarrjeve nga qiradhënia, enfiteozës të pronave të ndërmarrjeve, monitorimin e proçesit të privatizimit të pronave shtetërore, proçedurat e kalimeve kapitale të pronave të ndërmarrjeve të varësisë, proçedurat e ndërtimit dhe rindërtimit të këshillave drejtues të ndërmarrjeve me vetëfinancim të varësisë;
- Siguron një sistem të shëndoshë të kontrollit të brendshëm për përgatitjen e administrimit teknik, të proçedurave të këshillave drejtues të ndërmarrjeve jo buxhetore të varësisë, analizimin e treguesve ekonomikë financiarë të tyre, kalimet e kapitaleve të pasurive, qiradhëniet si dhe monitorimin e proçedurave të transformimit (privatizimit) të pasurive të ndërmarrjeve me vetëfinancim të varësisë së Bashkisë Tiranë.

Bazuar në sa më lart citohet, si dhe në praktikën e konsoliduar të Bashkisë Tiranë lidhur me nënshkrimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me shoqatat e invalidëve paraplegjikë e tetraplegjikë⁹, në kuadër të përmbushjes së detyrimit për dhënien falas të mjedisve në pronësi të saj, shoqatave të invalidëve paraplegjikë e tetraplegjikë; Komisioneri vëren se, në këtë kuptim, detyrimi i Bashkisë duhet të jetë i njëjtë dhe pa diferencime në trajtim, për të gjitha shoqatat e invalidëve paraplegjikë e tetraplegjikë të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre ligjore brenda juridiksionit territorial të saj, përfshirë këtu edhe subjektin ankues, “Shoqatën e Invalidëve Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë, Dega Tiranë”.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij:

⁹ Refruar Marrëveshjes së Bashkëpunimit me nr. 12408/1 prot., datë 23.03.2021, mes Bashkisë Tiranë dhe Shoqatës së Invalidëve Paraplegjike e Tetraplegjike të Shqipërisë.

“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre”.

Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi, i ndryshuar, në nenin 32/2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: *“Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin, duke i dhënë informacionin që i nevojitet dhe duke i garantuar aksesin në informacion në përmbushjen e detyrave të tij”.*

Nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë marrë të gjitha masat që subjekti kundër të cilit është bërë ankesa të vihet në dijeni për ankesën e bërë dhe i është ofruar mundësia që të japë shpjegime, informacion dhe dokumentacion provues mbi pretendimet e ngritura nga shoqata.

Në këto kushte, referuar dokumentacionit të administruar dhe korrespondencës shkresore të KMD-së drejtuar Bashkisë Tiranë, kjo e fundit, nuk vuri në dispozicion të Komisionerit, asnjë informacion, dokumentacion apo fakte të tjera, që të provonte se minimalisht po konsideronte mundësinë për pajisjen e Shoqatës me mjedise pune/zyrë, në përmbushje të kërkesave e detyrimeve ligjore për sa më sipër.

Bashkëlidhur parashtrimeve, Bashkia Tiranë ka dërguar kopje të dokumentacionit, komunikimit shkresor mes strukturave përkatëse të saj dhe Shoqatës së Invalidëve Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë të Shqipërisë, përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv, N. I.

Në parashtrimet e saj, Bashkia Tiranë i referohet si kthim përgjigje të problematikës së ngritur nga përfaqësuesi i “Shoqatës së Invalidëve Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë, Dega Tiranë”, A. P, por në citimin e shkresave dhe korrespondencës shkresore evidentohet se praktika dhe komunikimi është realizuar mes saj dhe Shoqatës së Invalidëve Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë të Shqipërisë. Pra, i gjithë dokumentacioni dhe veprimet e ndërmarra nga ana e Bashkisë Tiranë i korrespondojnë problematikës dhe zgjidhjes së kërkesave të Shoqatës së Invalidëve Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë të Shqipërisë, dhe jo kërkesës së subjektit ankues pranë KMD-së, Shoqatës së Invalidëve Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë, dega Tiranë, e cila është subjekt tjetër/person juridik, i ndryshëm nga ai që i referohet Bashkia, pavarësisht faktit se të dyja shoqatat kanë në fokus mbrojtjen e promovimin e të drejtave të së njëjtës kategori PAK.

Referuar deklarimeve e akteve të depozituara nga Shoqata, në përmbushje të sa më sipër, nuk rezulton që Bashkia të ketë ndërmarrë ndonjë veprim apo *masë konkrete dhe efektive*, për ofrimin e mjediseve të punës/zyrës në funksion të Shoqatës, subjekt ankues, pa kundërshtim.

Në këtë kontekst, Bashkia nuk i është përgjigjur kërkesave të Komisionerit për të sqaruar pozicionin e qëndrimin institucional të saj, në kuadër të zgjidhjes së problematikës së subjektit ankues, “Shoqatës së Invalidëve Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë Dega Tiranë”.

Evidentohet gjithashtu se, Bashkia nuk ka informuar Shoqatën dhe as Komisionerin gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, lidhur me konsiderimin e vlerësimit e mundësive të saj reale lidhur me ndonjë afat kohor të mundshëm, në funksion të përmbushjes së kërkesës së Shoqatës dhe detyrimit ligjor të Bashkisë, për pajisjen me mjedise të përshtatshme pune/zyre, bazuar në kriteret e përcaktuara ligjore, sa i takon aksesueshmërisë (*si persona me paraplegji e tetraplegji*) së zyrës në një zonë brenda qytetit të Tiranës.

Bazuar në sa më sipër cituar, Komisioneri vlerëson se, Bashkia Tiranë me mosveprimin e saj përsa i takon respektimit të së drejtës ligjore të Shoqatës për pajisjen me një mjedis pune/zyrë, nuk ka përmbushur detyrimin e saj ligjor, duke cënuar njëherësh edhe të drejtën e Shoqatës për ushtrimin e veprimtarisë së saj.

Nga analizimi i situatës, si dhe referuar ngjarjeve e fakteve, objekt hetimi, rezulton qartazi se, Bashkia Tiranë, ka trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme subjektin ankues, “Shoqatën e Invalidëve Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë, Dega Tiranë”, në raport me të drejtën e tyre ligjore, për pajisjen me një mjedis pune/zyrë pa kundërshtëpërblim, për ushtrimin e funksionit të Shoqatës dhe përmbushjen e qëllimit për të cilin ajo është krijuar e funksionon.

B. Shkaku i mbrojtur.

Mbështetur në nenin 2¹⁰, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në ushtrimin e detyrës së tij siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin për një nga shkaqet që parashikon ky ligj. Ky ligj, ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Në nenin 1 të tij përcaktohet se: “*Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër*”.

Në çështjen Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar (paragrafi 60) GJEDNJ-ja është shprehur se: “*Pyetja nëse ekziston një ndryshim në trajtim bazuar në një karakteristikë personale ose të identifikueshme, në çdo rast është një çështje që duhet vlerësuar duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e çështjes dhe duke pasur parasysh se qëllimi i Konventës është të garantojë jo të drejta që janë teorike ose jo reale, por të drejta që janë praktike dhe efektive*”.

¹⁰“*Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për: a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b)barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga cdo forme sjelljeje që nxit diskriminim.*”

B/1 Aftësia e kufizuar

Subjekti ankues, “Shoqata e Invalidëve Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë, Dega Tiranë”, ka pretenduar diskriminim për shkak të “aftësisë së kufizuar”, për shkak të statusit të saj si OJF, pra, si person juridik, që ushtron veprimtarinë në kuadër të mbrojtjes të të drejtave të personave që gëzojnë statusin e personit me paraplegji dhe tetraplegji.

Fakti sipërcituar, del qartë nga aktet e njohjes së Shoqatës ku është përcaktuar se kjo Shoqatë ushtron veprimtarinë e saj pikërisht në mbrojtje dhe promovim të të drejtave të kësaj kategorie personash.

Konventa e OKB-së “Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara¹¹”, në nenin 1 të saj, ka përcaktuar se: *“Personat me aftësi të kufizuara përfshijnë ata që kanë dëmtime fizike, mendore, intelektuale apo shqisore afatgjata, të cilat, në ndërveprim me barriera të ndryshme, mund të pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri në baza të barabarta me të tjerët”*.

Ligji nr. 8626, datë 22.06.2000 “*Statusi i Invalidit Paraplegjik dhe Tetraplegjik*”, i ndryshuar, si dhe një sërë aktesh të tjera ligjore e nënligjore kanë legjitimuar posedimin e statusit të personit me paraplegji e tetraplegji si aftësi të kufizuar.

Referuar nenit 1, të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, ky shkak i pretenduar nga subjekti ankues konsiderohet si shkak i mbrojtur, pasi parashikohet si i tillë në LMD, si dhe subjekti ankues ka depozituar prova të cilat faktojnë se e mbart atë. Bazuar në shkaqet e mbrojtura të përcaktuara në nenin 1, si dhe duke ju referuar përkufizimit të diskriminimit që ligji ka bërë në nenin 3, të ligjit “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit garantohej vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme dhe të padrejta që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura. Në mungesë të një shkakut të mbrojtur jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim i pafavorshëm konsiderohet diskriminim sipas ligjit.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson të provuar shkakun e pretenduar të diskriminimit, atë të aftësisë së kufizuar.

C. Lidhja e trajtimit të padrejtë dhe të pafavorshëm me shkakun e mbrojtur.

Komisioneri ka shqyrtuar dhe analizuar faktin, nëse “subjekti ankues”, Shoqata, është trajtuar në mënyrë të padrejtë apo të pafavorshme nga ana e Bashkisë Tiranë, në raport me parashikimet ligjore të posaçme, lidhur me të drejtën për të poseduar një ambient të përshtatshëm për ushtrimin e funksionit e aktivitetit të tyre, pa kundërshtim.

¹¹ Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr. 108/2012.

Çështjet e diskriminimit kërkojnë që të vërtetohet nëse ekziston një përlligje e arsyeshme dhe objektive për trajtimin ndryshe të evidentuar.

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Kushtetuta si akti themeltar i Republikës së Shqipërisë, sanksionon se: *“Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme, të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik”*. Neni 18, i saj shpreh se: *“Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit”*.

Në nenin 59, shkronjat e) dhe f) të saj ka parshikuar se:

“Shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në plotësim të nismës dhe të përgjegjësisë private, synon:

e) përkujdesjen dhe ndihmën për të moshuarit, jetimët dhe invalidët;

f) riaftësimin shëndetësor, edukimin e specializuar dhe integrimin në shoqëri të të paaftëve, si dhe përmirësimin në vazhdimësi të kushteve të tyre të jetesës”.

Gjykata Kushtetuese, në jurisprudencën e saj, ka mbajtur qëndrimin se, parimi i shtetit të së drejtës detyron të gjitha organet e pushtetit publik që t’i ushtrojnë kompetencat e tyre vetëm në respektim të normave kushtetuese. Aktet juridike që nxirren nga këto organe duhet të jenë në pajtim me aktet juridike më të larta, si në kuptimin formal të tyre, ashtu edhe atë material. Respektimi i hierarkisë së akteve normative është një detyrim që buron nga parimi i shtetit të së drejtës dhe i koherencës në sistemin ligjor¹².

Me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, e drejta ndërkombëtare që rrjedh nga marrëveshjet ndërkombëtare (e njohur ndryshe edhe si *“e drejta konventore”*) ka një vend të posaçëm.

Sipas nenit 116 të Kushtetutës, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj, në hierarkinë e normave juridike renditen menjëherë pas Kushtetutës. Për pasojë, ato zënë një vend të rëndësishëm në të drejtën e brendshme e bëhen të detyrueshme për t’u zbatuar për çdo shtet, për të gjithë organet shtetërore.

Po ashtu, kjo dispozitë kushtetuese duhet lexuar në harmoni edhe me nenin 122, pikat 1 dhe 2, të Kushtetutës, ku sanksionohet se:

“1. Çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar përbën pjesë të sistemit të brendshëm juridik pasi botohet në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë. Ajo zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, përveç rasteve kur nuk është e vetëzbatueshme dhe zbatimi i saj kërkon nxjerrjen e një ligji...

2. Një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të...

¹² Citojmë këtu, Vendimet e Gjykatës Kushtetuese me: nr. 2, datë 03.02.2010, nr.1, datë 12.01.2011, nr. 23, datë 08.06.2011.

Shqipëria ka nënshkruar e ratifikuar disa akte ndërkombëtare, që në thelb kanë të bëjnë me trajtimin e barabartë, mosdiskriminimin, mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në përgjithësi, ndër të cilat është edhe Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, e cila jo vetëm që është pjesë e e legjislacionit të brendshëm të Republikës së Shqipërisë, por zë një vend të veçantë brenda tij. Konventa njeh dhe parashikon kufizime të përgjithshme dhe kufizime specifike për të drejta të veçanta.

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ-ja), në nenin 14 të saj, ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, bazuar në një listë joshteruese shkaqesh. Ndërkohë Protokollin 12-të i Konventës, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me “gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji” dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja.

Në veçanti, fusha e mbrojtjes sipas nenit 1, të Protokollit të 12, të KEDNJ përfshin rastet kur subjekti është diskriminuar:

a) në gëzimin e çdo të drejte ligjore të njohur shprehimisht me ligj të veçantë;

b) në gëzimin e çdo të drejte që rrjedh nga një detyrim i qartë i autoritetit publik sipas legjislacionit të brendshëm, sa kohë autoriteti ka detyrimin të dëshmojë një sjellje të caktuar mbi bazën e ligjit të brendshëm;

c) nga autoriteti publik në ushtrimin e kompetencës diskrecionare;

d) nga çdo akt apo mosveprim tjetër i autoritetit publik”.

Shqipëria e ratifikoi Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar, në Dhjetor të vitit 2012 dhe është bërë Palë në të, që prej 11 Shkurtit 2013.

Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar (KDKPAK)¹³, ka për qëllim të nxisë, mbrojë dhe të sigurohet që të gjithë personat me aftësi të kufizuar të gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të nxisë respektin për dinjitetin e tyre.

Në kuptimin të kësaj Konvente: “Diskriminimi për shkak të aftësisë së kufizuar” ka kuptimin e çdo dallimi, përjashtimi apo kufizimi për shkak të aftësisë së kufizuar, që ka si qëllim ose ndikon në pengimin apo mohimin e njohjes, gëzimit apo ushtrimit, njësoj si gjithë të tjerët, të të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në fushën politike, ekonomike, shoqërore, kulturore, civile apo në ndonjë fushë tjetër. Në këtë përkufizim përfshihen të gjitha format e diskriminimit, duke përfshirë edhe mohimin e përshtatjes brenda logjikës”.

Parimet e kësaj Konvente përfshijnë:

a) Respektin për dinjitetin, autonominë individuale përfshirë lirinë për të bërë zgjedhjet personale, dhe pavarësinë e personit;

¹³ Shqipëria e ratifikoi KDKPAK në Dhjetor të vitit 2012 dhe është bërë Palë në të që prej 11 Shkurtit 2013.

- b) Mosdiskriminimin;
- c) Pjesëmarrjen dhe përfshirjen e plotë dhe efektive në shoqëri;
- d) Respektin për ndryshimin dhe pranimin e personave me aftësi të kufizuara si pjesë e diversitetit njerëzor dhe humanizmit;
- e) Mundësi të barabarta;
- f) Akses;
- g) Barazi ndërmjet burrave dhe grave;
- h) Respekt për kapacitetet në zhvillim të fëmijëve me aftësi të kufizuara, si edhe respektimi i të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuara për të ruajtur identitetin e tyre.

Neni 5 i Konventës, ka përcaktuar se:

- “1. Shtetet Palë pranojnë se të gjithë personat janë të barabartë përpara ligjit dhe se gëzojnë të drejtë pa asnjë diskriminim për mbrojtje të barabartë dhe përfitim të barabartë nga ligji.
2. Shtetet Palë duhet të ndalojnë çdo lloj diskriminimii për shkak të aftësisë së kufizuar dhe t’u garantojnë personave me aftësi të kufizuara mbrojtje ligjore të barabartë dhe efektive ndaj çdo lloj diskriminimi dhe në cdo rrethanë.
3. Me qëllim nxitjen e barazisë dhe eliminimit të diskriminimit, Shtetet Palë duhet të ndërmarrin të gjitha hapat e duhura për tu siguruar se është ofruar akomodim i arësyeshëm.
4. Masat specifike të cilat janë të nevojshme për të përshpejtuar apo arritur de facto barazinë e personave me aftësi të kufizuara nuk do të konsiderohen diskriminim sipas termave të kësaj Konvente” .

Në nenin 29, shkronjat a) dhe b) të Konventës, përcaktohet se:

“Shtetet Palë duhet t’u garantojnë personave me aftësi të kufizuara të drejtat politike dhe mundësinë për t’i gëzuar ato njësoj si pjesa tjetër e popullësisë dhe duhet të marrin përsipër: a) T’u garantojnë personave me aftësi të kufizuara pjesëmarrjen e plotë dhe efektive në jetën politike dhe publike njësoj si gjithë të tjerët, drejtpërsëdrejti apo nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur...c) Garantimin e një ambienti, në të cilin personat me aftësi të kufizuara mund të marrin pjesë në mënyrë efektive dhe të plotë në dirigjimin e çështjeve publike, pa diskriminim dhe njësoj si të tjerët dhe të inkurajojë pjesëmarrjen e tyre në çështjet publike...”.

Për një kohë të gjatë, personat me aftësi të kufizuara janë parë më shumë si objekte se sa si subjekte të së drejtës, duke evidentuar dhe theksuar paaftësinë/të. Ndërkohë, qasja e re që ofron Konventa “Për të drejtat e personave e aftësi të kufizuara” bazohet jo më në modelin e “bamirësisë”, por në atë të të drejtave të njeriut, ku personat me aftësi të kufizuara, si të gjithë qeniet njerëzore, i zotërojnë të drejtat e tyre në mënyrë të pakushtëzuar.

Në qendër të vëmendjes nuk është paaftësia e mundshme, por barrierat që vendos shteti apo shoqëria, duke penguar gëzimin e tyre. Barrierat janë të shumëllojshme, ku përveç barrierave fizike, barrierat e ndryshme shoqërore të bazuara në stereotipe, çojnë drejt përjashtimit të personave me aftësi të kufizuara dhe potencialisht mbështesin këtë përjashtim.

Konkretisht, Konventa "Për të drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara", në nenin 4 ku parashikon "Detyrimet e përgjithshme", sanksionon shprehimisht se: "Në zhvillimin dhe zbatimin e legjislacionit për zbatimin e kësaj Konvente, si dhe për proceset e tjera vendim-marrëse në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me personat me aftësi të kufizuara. Shtetet Palë duhet të konsultohen në mënyrë aktive me personat me aftësi të kufizuara, përfshirë këtu edhe fëmijët me aftësi të kufizuara për të siguruar përfshirjen e tyre nëpërmjet organizatave të tyre përfaqësuese".

Ligji nr. 93/2014 "Për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara", parashikon gjithë-përfshirjen dhe një rol aktiv të organizatave në mbrojtjen e interesave të personave me aftësi të kufizuara.

Kështu, ndër parimet bazë të këtij ligji, sipas nenit 4 të tij, është pjesëmarrja e personave me aftësi të kufizuara nëpërmjet konsultimit individual dhe përfshirjes aktive të personave me aftësi të kufizuara dhe organizatave të tyre përfaqësuese, përfshirë fëmijët me aftësi të kufizuara. Organizatë për personat me aftësi të kufizuara, sipas nenit 3 pika 8, përkufizohet si çdo organizatë jofitimprurëse, që ofron shërbime për personat me aftësi të kufizuara dhe/ose kryen aktivitetet në mbrojtje të interesave të këtyre personave e të familjeve të tyre.

Ligji nr. 93/2014 "Për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara", i ndryshuar, ka për qëllim:

"a) të garantojë nxitjen dhe mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara për të mundësuar pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në të gjitha sferat e shoqërisë, në kushte të barabarta me të tjerët, duke mundësuar autonominë dhe jetesën e pavarur për të gjithë personat me aftësi të kufizuara, nëpërmjet ofrimit të ndihmës e të mbështetjes;

b) të përcaktojë përgjegjësinë e të gjitha strukturave publike dhe jopublike, përfshirë organet shtetërore, qendrore dhe vendore, në zbatimin e parimeve të përfshirjes dhe aksesueshmërisë për të zvogëluar, deri në heqje, pengesat për personat me aftësi të kufizuara, me qëllim mundësimin e pjesëmarrjes së tyre të barabartë në shoqëri".

Në këtë ligj:

"Aksesueshmëri" është mënjanimi i pengesave të të gjitha llojeve;

- "Pengesat" nënkupton: ...ç) pengesat institucionale, përfshirë ato në legjislacion dhe politika.

Parimet bazë të këtij ligji janë:

- a) mosdiskriminimi, me anë të të cilit garantohet se personat me aftësi të kufizuara të mos trajtohen në mënyrë të diferencuar, nisur nga dëmtimi që kanë;

.....

- ç) garantimi i aksesueshmërisë nëpërmjet mënjimit të pengesave të të gjitha llojeve;

Sa më lart, ku termi "aksesueshmëri" përcakton mënjanimin e pengesave të të gjitha llojeve, përfshirë edhe pengesat institucionale, ato në legjislacion dhe në politikat e ndryshme hartuar në ndihmesë të personave me AK.

Ligji nr. 8626, datë 22.06.2000 “*Statusi i Invalidit Paraplegjik dhe Tetraplegjik*”, i ndryshuar, në nenin 14 të tij, ka përcaktuar shprehimisht se:

“Shteti merr përsipër të vërë në dispozicion dhe të japë falas mjedise për zhvillimin e veprimtarisë së shoqatës së invalidëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë”.

Në analizë të dispozitës të sipërcituar, evidentohet që neni 14 i këtij Ligji, parashikon në mënyrë eksplicite dhe të shprehur të drejtën e Shoqatës, subjekt ankues pranë KMD-së, për përfitimin falas nga të një mjedisi për ushtrimin e veprimtarisë e aktivitetit të saj.

Për rrjedhojë, bazuar sa më sipër, si dhe në shqyrtim të pretendimit të Shoqatës, Komisioneri konstaton se, nga ana e Bashkisë hapatazi është shkelur dispozita e mësipërme ligjore.

Sipas nenit 3, pika 1 të ligjit “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, diskriminimi përkufizohet si: *“çdo dallim, përrjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.*

Një nga format e diskriminimit parashikuar nga ligji, është diskriminimi i drejtpërdrejtë, i cili përkufizohet nga neni 3/2, i ligjit si një *situatë diskriminimi që ndodh kur një person apo grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, apo një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji.*

Neni 20/1 i LMD-së, përcakton qartë detyrimin e personave fizik ose juridik që ofrojnë të mira apo shërbime për publikun, duke cituar shprehimisht:

“1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato: a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.

2. Pika 1 e këtij neni zbatohet veçanërisht për: c) kontributin dhe mundësinë për të përfituar të mira nga skemat e mbrojtjes shoqërore, duke përfshirë asistencë sociale, sigurime shoqërore, mbrojtje të fëmijëve, përfitim për shkak të aftësisë së kufizuar, apo ndonjë skemë tjetër të mbrojtjes sociale ose avantazh tjetër social të ofruar për publikun”.

Bazuar në nenin 82, pika 2 të Kodit të Procedurave Administrative përcaktohet se: *“Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të*

provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”.

Në të njëjtën frymë është dhe ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, i cili, në nenin 33, pikën 7/1 të tij, ka përcaktuar se: “Në rastet kur pala ankuese paraqet fakte mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim”.

Duke qenë se pala kundër të cilës drejtohet ankesa disponon gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të provuar bazueshmërinë e pretendimeve, legjislacioni i ka transferuar barrën e provës palës kundër të cilës është paraqitur ankimi, kur vihet re se *prima facie* është ngritur një pretendim për diskriminim. Pala kundër të cilës është paraqitur ankesa ka barrën e provës të provojë se trajtimi i diferencuar nuk është diskriminues.

Sa më sipër, “subjekti ankues” duhet të krijojë një prezumim të diskriminimit (diskriminimi *prima facie*), barra më pas kalon tek subjektet kundër të cilëve është drejtuar ankesa, të cilët duhet të tregojnë se ndryshimi në trajtim nuk është diskriminues. Kjo mund të bëhet:

1. Ose duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë.
2. Ose duke demonstruar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv.

Nëse subjekti që pretendohet se ka konsumuar sjelljen diskriminuese nuk është në gjendje të provojnë njërin nga të dyja, atëherë do të jetë përgjegjës për diskriminimin.¹⁴

Sa më sipër, për të vlerësuar pretendimin për diskriminim të parashtruar nga subjekti ankues/Shoqata, *së pari*, Komisioneri ka vlerësuar dhe ka arritur në përfundimin se Shoqata i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe më pak të favorshëm, në të drejtën për të marrë shërbimin nga ana e Bashkisë Tiranë.

Së dyti, Komisioneri, do të vlerësojë nëse ky trajtim i padrejtë, i pafavorshëm i subjektit ankues, nga ana e Bashkisë, lidhet me shkakun e mbrojtur.

Mbështetur në faktet dhe provat e depozituara gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës, si dhe analizimit të legjislacionit përkatës¹⁵, Komisioneri vlerëson se subjekti ankues, Shoqata, i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm nga ana e Bashkisë Tiranë, në raport me lehtësirat e parashikuara drejtpërdrejtë në legjislacionin e sa më sipër analizuar.

Subjekti ankues ka pretenduar se është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme, nga ana e Bashkisë Tiranë, përmes mosfrimit të një mjedisi pune/zyrë, megjithëse ligji, subjekti i të cilit

¹⁴ https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018_en.pdf, fq.232.

¹⁵ Shih Ndarjen III, nëndarja A.I, të vendimit të KMD.

janë, ua njeh këtë të drejtë, dhe po ashtu përcakton dhe detyrimin ligjor të shtetit, Bashkisë në këtë rast, për të përmbushur kërkesën e Shoqatës.

Fakti i posedimit së shkakut të mbrojtur nga ana e subjektit ankues, Shoqatës, rezulton i njohur dhe i pranuar nga ana e Bashkisë, pasi pikërisht bazuar në këtë shkak, ata deri në muajin shkurt 2022, i kishin vënë në dispozicion asaj, mjedise pune (në pronësi të Bashkisë), për përdorim pa kundërshpërblim nga ana e Shoqatës.

Komisioneri vlerëson se, shteti duhet t'u sigurojë mbrojtje efektive dhe barazi në trajtim të gjithë personave me aftësi të kufizuara, në mënyrë që ata të marrin pjesë në jetën shoqërore njëllor si të tjerët, si dhe mundësisht t'u garantohet jetesa e pavarur. Mundësia e posedimit të një mjedisi të përshtatshëm për ushtrimin e veprimtarisë së Shoqatës, e cila në fokus të veprimtarisë së saj ka mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, është një element i rëndësishëm në garantimin e ushtrimit dhe funksionimit të punës së tyre, për të cilën ajo ekziston si e tillë¹⁶.

Në kushtet kur shteti, krijon lehtësira të caktuara përmes parashikimeve specifike në akte ligjore apo nënligjore të tij, për kategoritë përfituese të individëve (Shoqatave), duhet të sigurohet që t'i ofrojë këto shërbime pa asnjë lloj diskriminimi, të çfarëdolloj forme.

Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021-2025¹⁷, citon ndër të tjera se:

“Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuar (PKVPAK) 2021-2025, është një dokument ndërsektorial i qeverisë shqiptare që përfshin politika të dedikuara për personat me aftësi të kufizuara e që do të hidhen për zbatim gjatë 5 vjeçarit të ardhshëm. Qëllimi i tij është të vazhdojë promovimin dhe mbështetjen e integritit të personave me aftësi të kufizuara në jetën social-ekonomike të vendit duke patur në vëmendje të vazhdueshme përmbushjen e detyrimeve të KDPAK përmes masave specifike.

Procesi i hartimit të këtij dokumenti përputhet edhe me një moment tjetër të rëndësishëm të zbatimit të politikave për aftësinë e kufizuar në Shqipëri në funksion të realizimit të parimeve të KDPAK, të ratifikuar nga shteti shqiptar.

Qëllimi, objektivat specifike dhe masat e parashikuara në këtë plan për realizimin e aksesueshmërisë, adresojnë reduktimin e barrierave për personat me aftësi të kufizuara, me qëllim: (i) sigurimin e aksesit në të mirat materiale, shërbimet dhe lehtësirat; (ii) sigurimin dhe mbajtjen e vendit të punës; (iii) përfshirjen dhe pjesëmarrjen në komunitet; (iv) ndryshimet në sjelljet, qëndrimet dhe veprimet, të cilat diskriminojnë personat me aftësi të kufizuara.

Politika orienton institucionet publike në masat që ato duhet të marrin për realizimin e aksesueshmërisë për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara në: (i) mjedise; (ii) transport; (iii) informacion e komunikim”.

¹⁶ Për analogji, citojmë Vendimin nr. 192, datë 11.10.2021, të KMD-së.

¹⁷ Draft final

Ky dokument thekson faktin se, qeveria është e angazhuar të administrojë në mënyrë aktive çështjen e aftësisë së kufizuar në Shqipëri duke përditësuar gjithmonë e më shumë të drejtat e PAK në politikat e saj sektoriale. Për arritjen e këtij qëllimi është e nevojshëm edhe mbështetja më e fuqishme kundrejt OJF që vepron për mbrojtjen, zhvillimin e promovimin e personave me aftësi të kufizuara në Shqipëri.

Referuar parashikimeve specifike në legjislacionin ndërkombëtar të ratifikuar nga Shqipëria, legjislacionin e brendshëm, si dhe standardet ndërkombëtare dhe kombëtare; barazia dhe mosdiskriminimi i personave me aftësi të kufizuara, duhet kuptuar jo vetëm midis personave me aftësi të kufizuara dhe personave të tjerë, por dhe midis llojeve e kategorive të ndryshme të aftësisë së kufizuar.

Bazuar në aktet e administruara dhe konstatimet e mësipërme, Komisioneri vlerëson se, në pamje të parë, pra *prima facie*, faktet dhe provat e administruara krijojnë prezumimin se, subjekti ankues, Shoqata, mund të jetë trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme, nëpërmjet mosveprimeve të Bashkisë Tiranë, megjithëse posedonte shkakun e mbrojtur nga ligji, atë të aftësisë së kufizuar dhe Bashkia ishte në dijeni të plotë të këtij fakti.

Në këto kushte Bashkia, kishte barrën e provës që të provonte, që megjithëse trajtimi i pafavorshëm është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv.

Neni 285¹⁸, i Kodit të Procedurës Civile, të ndryshuar, ka parashikuar se, kur pala nuk paraqitet ose refuzon të përgjigjet pa shkaqe të justifikuara, duke vlerësuar edhe provat e tjera, mund të merren si të pranuar faktet e parashtruara në pyetjet e drejtuara palës. (*Bashkisë në këtë rast*).

Në këtë kontekst, Bashkia nuk solli asnjë parashtrim, dokumentacion, fakt apo provë, lidhur me sa më sipër, megjithë detyrimin e saj për t'u përgjigjur e për të bashkëpunuar insitucionalisht me KMD-në, në funksion të sqarimit e zgjidhjes së problematikës së shqyrtuar, megjithëse kishte marrë dijeni shkresërisht për të.

Referuar kuponëve të shërbimit postar lidhur me marrjen në dorëzim të shkresave të KMD-së, si dhe shkresës me nr. 21727/2 prot., datë 13.07.2022, me të cilën Bashkia Tiranë dërgoi parashtrimet e veta lidhur me sqarimin e problematikës së Shoqatës së Invalidëve Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë të Shqipërisë, dhe jo të subjektit ankues, Shoqatës së Paraplegjikëve dhe Tetraplegjikëve, Dega Tiranë.

Komisioneri thekson faktin se këto dy shoqata janë subjekte të ndryshme juridike, të cilat operojë veçmas dhe ushtrojnë veprimtarinë e tyre të pavarura nga njëra-tjetra, bazuar ë statutet dhe aktet rregullatore përkatëse, dhe të njohura si të tilla, sipas vendimeve respektive të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Për rrjedhojë, Komisioneri vlerëson si të pranuar prej Bashkisë, faktin se nga ana e saj nuk është ndërmarrë asnjë veprim apo hap procedural në përmbushje të së drejtës së Shoqatës për t'u pajisur me një mjedis të përshtatshëm pune/zyrë në funksion të ushtrimit të veprimtarisë së saj.

¹⁸“Mosparaqitja dhe refuzimi i përgjigjes nga pala”

Mosdiskriminimi është një e drejtë kushtetuese, e detyrueshme për t'u zbatuar drejtpërsëdrejti nga institucionet. Kjo e drejtë është sanksionuar dhe mbrohet edhe me ligjin nr. 10221 datë 04.02.2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", të ndryshuar.

Për të qenë përpara një veprimi diskriminues në kuptim të këtij ligji, Komisioneri vlerëson se, duhet të plotësohen tre kushte njëherësh:

- Të ekzistojë trajtimi i diferencuar i ankuesit në raport me të tjerët në kushte, rrethana të njëjta apo të ngjashme;
- Trajtimi i diferencuar të ketë ndodhur për një nga shkaqet e parashikuara në nenin 1, të këtij ligji;
- Trajtimi i diferencuar të ketë sjellë si pasojë vështirësinë apo pamundësinë e ankuesit për të ushtruar të drejtat dhe liritë e njohura nga kushtetuta, aktet ndërkombëtare të ratifikuara apo ligjet e tjera në fuqi.

Në përfundim të analizimit të çështjes në tërësi, Komisioneri vlerëson se, në rastin e subjektit ankues përmbushen të tre këto kushte njëherësh dhe se, trajtimi i padrejtë dhe i disfavorshëm i subjektit ankues, Shoqatës, nuk ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv.

Në konkluzion të sa më sipër, Komisioneri konstaton se Bashkia Tiranë, me mosveprimet e saj, ka diskriminuar subjektin ankues, "Shoqatën e Invalidëve Paraplegjikë e Tetraplegjikë Dega Tiranë", në të drejtën e saj për të gëzuar të mirat dhe shërbimet, përsa i takon të drejtës për posedimin e një mjedisi të përshtatshëm pa kundërshpërblim, në funksion të ushtrimit të veprimtarisë së saj.

Për rrjedhojë Bashkia Tiranë, ka shkelur dispozitat e ligjit "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", të ndryshuar, respektivisht: nenin 3, pikat 1 dhe 6, dhe nenin 20, pika 1, shkronja a), dhe nenin 4, të tij.

Bazuar në nenin 33, pika 10 të ligjit "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", të ndryshuar, përcaktohet se: "*Vendimi përmban rregullimet dhe masat e duhura, duke caktuar edhe një afat për kryerjen e tyre*".

Në nenin 33, pika 12, të LMD-së, përcaktohet se: "*Kur vendos masën, Komisioneri siguron që ajo të jetë: a) e efektshme dhe parandaluese; dhe b) në përputhje me gjendjen që e shkaktoi vendosjen e masës*".

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vlerëson se masa e duhur për rregullimin e situatës diskriminuese të shkaktuar, duhet të jetë rivendosja në vend e të drejtës së shkelur të subjektit ankues nga ana e Bashkisë Tiranë, dhe kjo mund të realizohet nëpërmjet ofrimit nga ana e Bashkisë, të një mjedisi të përshtatshëm për ushtrimin e funksionit dhe aktivitetit të "Shoqatës së Invalidëve Paraplegjikë e Tetraplegjikë, Dega Tiranë", (bazuar në kërkesën e saj dhe kriteret ligjore specifike), brenda qytetit të Tiranës.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 1, nenin 3, pikat 1 dhe 6, nenin 7, nenin 20 pika 1, germa a) dhe pika 4, e tij, nenin 32, shkronja b), si dhe nenin 33, pikat 7/1, 10, 11 dhe 12, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit të subjektit ankues, “Shoqatës së Invalidëve Paraplegjikë e Tetraplegjikë, Dega Tiranë”, në fushën e të mirave dhe shërbimeve, nga ana e Bashkisë Tiranë, për shkak të aftësisë së kufizuar.
2. Në referim të pikës 1, Bashkia Tiranë, të marrë masa për ndreqjen e pasojave dhe rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur të subjektit ankues.
3. Bazuar në nenin 33 pika 11, të ligjit “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Bashkia Tiranë, detyrohet që brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.
4. Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010, “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni.
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankimim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Hartoi: R. Hoxha
Rishikoi: R. Babaj
Konfirmoi: V. Bushati
Datë: 30.06.2022